



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Florije Rexhepi	20.09.2023	06.10.2023	2023/0701
Eksperti Teknik	Data e autorizimit të ekspertit teknik		
vigan syla	22.09.2023		

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 14.09.2023, OE “H & B - Consulting SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0701, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë “Grupi i Operatoreve Ekonomik “ AAG Projekt, Top Projekt Sh.P.K, Euro-services shpk, Ego Elsa Sh.P.K” , Agim Ramadani Nr. 82/7- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Ndertimi i objektit për klinikat Nefrologji dhe Hemato-Onkologji” me nr. të prokurimit: "701-23-1939-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVES.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontrates: pune, vlera e parashikuar e kontratës: 4,669,683.75 €.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim: Data e njoftimit për kontratë: 13.03.2023 data e hapjes së ofertës: 27.04.2023, data e njoftimit mbi vendimin e AK-se: 31.08.2023, data e njoftimit me letër standarde: 31.08.2023.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

QKUK - ka shkelur këto Dispozita Ligjore të LPP-së, si ne vijim:

- Neni 1 par. 1 dhe 2 të LPP-së
- Neni 2 të LPP-së
- Neni 6 të LPP-së
- Neni 7 të LPP-së
- Neni 24 par. 2 dhe 3 te LPP-së
- Nenin 52 te LPP-së
- Neni 52 par. 5 dhe 7 të LPP-së.
- Neni 56 të LPP-së.
- Neni 59 par. 1, 2 dhe 4 të LPP-së
- Neni 60 par. 1.1 te LPP-së.
- Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë
- Nenin 108/A par. 8 dhe 12 i LPP-së
- Neni 38 të Rregullores 001/2022 për PP
- Neni 39 të Rregullores 001/2022 për PP
- Neni 40.3 të Rregullores 001/2022 për PP
- Neni 40.6 të Rregullores 001/2022 për PP
- Neni 40.9 të Rregullores 001/2022 për PP
- Neni 40.12 të Rregullores 001/2022 për PP
- Neni 45.19 të Rregullores 001/2022 për PP
- Neni 45.21 të Rregullores 001/2022 për PP
- Neni 45.23 i Rregullores 001/2022 për PP
- Neni 48 i Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative
- Neni 40. Rreg. Nr. 01/2022 për PP Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

KRITERET PËR VLERËSIM

		Kërkesat e përshtatshmërisë: Kërkesa 1. Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP)	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> Evidenca 1. Një deklaratë e shkruar nën <u>Betim</u>, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2. Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë do të kërkojnë nga tenderuesi të cilit SHSKUK ka ndërmend që t’ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të SHSKUK-së, për synimin e dhënies së kontratës. Dështimi për të paraqitur një nga këto dokumente brenda afatit kohor të përmendur, do të thotë që tenderuesi do të refuzohet, do të konfiskohet garancioni i sigurimit të ofertës dhe SHSKUK do të vazhdojë me tenderuesin e radhës në rang-listë. Dokumentet të cilat do të kërkojnë si dëshmi për përmbushje të kërkesave të pranueshmërisë janë me se vijon a. Për situatën referuar pikës 6.2 [a,b,c,d, e dhe f] dhe pikës 6.3 [a,b dhe d], vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit. (originali ose kopja e noterizuar) Për situatën referuar pikës 6.3 [h (tatimit)], vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit [para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës]. (kopje)
Kërkesat e përshtatshmërisë	7.1 & 7.2	Përshtatshmëria profesionale: Kërkesa 1. Certifikatë e regjistrimit të biznesit , regjistrimi si operator	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> Evidenca 1. Te dëshmohet me Certifikatë të Regjistrimit

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “H & B - Consulting SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i objektit për klinikat Nefrologji dhe Hemato-Onkologji” me numër të prokurimit: “701-23-1939-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVES

profesional e		ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit	te Biznesit si dhe me informacione te biznesit-Kopje
		Kërkesa 2. Certifikatë e numrit fiskal	Evidenca 2. Te dëshmohet me Certifikatë te Numrit Fiskal- Kopje
		Kërkesa 3. Certifikatë e TVSh-së.	Evidenca 3. Te dëshmohet me Certifikatë te TVSh-së Kopje
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	Kapaciteti ekonomik dhe financiar: Kërkesa 1. Operatori ekonomik ofertues duhet të ofrojë dëshmi se qarkullimi vjetor i tij, gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit për kontratë ka qenë gjithsej jo më pak se 6,000,000.00 €.	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> Dëshmia 1. Qarkullimi vjetor për tri vitet e fundit nga data e njoftimit për kontratë jo më pak se 6,000,000.00 €. Dëshmia 1.1. Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës, për OE të cilët kanë pasur qarkullim jashtë vendit dëshmi të admistratas tatimore ose autoritetit perkatës të atij vendi, për tri vitet e fundit të përfunduara fiskale nga data e njoftimit për kontratë (2020,2021 dhe 2022) jo më pak se 6,000,000.00 €(kopje).
	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe profesional: Kërkesa 1. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ofrojë një listë te kontratave te natyrës se ngjashme (ndertime te larta) te përfunduar me sukses ne tri vitet e shkuara nga data e publikimit te këtij njoftimit për kontratë, te percjellur me referenca apo raporte te pranimit ku vlera e te cilave duhet te jete minimum 6,000,000.00 €.	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare</i> Dëshmia 1. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ofrojë dëshmi një listë te kontratave te natyrës se ngjashme (ndertime te larta) te përfunduar me sukses ne tri vitet e shkuara nga data e publikimit te këtij njoftimit për kontratë, te percjellur me referenca apo raporte te pranimit ku vlera e te cilave duhet te jete minimum 6,000,000.00 €. Lista duhet ti permbaje te dhenat si <u>Daten</u> e nenshkrimit, <u>Daten</u> e perfundimit, <u>Titullin</u> e Kontrates, <u>Autoritetin Kontraktues</u> , <u>Vleren</u> e projektit.

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	Kërkesa 2. Menaxher i projektit-Inxhinier i dip. Ose kualifikimi Master i ndërtimtarisë ose i Arkitekturës me min. 5 vite. përvojë pune pas diplomimit	Dëshmia 2. Për inxhinier <u>Diploma</u> , CV-të origjinal të nënshkruar nga inxhinieri, referencat. Kontrata e punës valide ose parakontrat lidhur me punëdhënësin per kete projekt
	Kërkesa 3. Menaxher i Punishtes - Inxhinier i dip. Ose kualifikimi Master i Ndërtimtarisë me min. 5 vite përvojë pune pas diplomimit.	Dëshmia 3. Për inxhinier <u>Diploma</u> , CV-të origjinal të nënshkruar nga inxhinieri, referencat. Kontrata e punës valide ose parakontrat lidhur me punëdhënësin per kete projekt
	Kërkesa 4. Staf i inxhinierve : Një (1) inxhinier i Arkitekturë, Një (1) inxhinier i Ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv, Një (1) inxhinier i Ndërtimtarisë – drejtimi hidro, Një (1) inxhinier i Elektros, Një (1) inxhinier i Mekanikës	Dëshmia 4. Inxhinierët të dokumentojnë diplomat universitare (kopje) master apo diploma me studime 5 vjeqare, përvojë pune minimum 5 vite pas diplomimit sipas profilit të drejtimt, CV , Kontrata e punës valide ose parakontrat lidhur me punëdhënësin per kete projekt
	Kërkesa 5. Teknolog për gazra medicinale ose Ing. diplomuar i makinerisë (Master i inxhinierisë mekanike) minimum 1	Dëshmia 5. <u>certifikat</u> profesionale apo diplomë per titull akademik, <u>CV</u> , Kontrata e punës valide ose parakontrat lidhur me punëdhënësin per kete projekt.
	Kërkesa 6. Listë të nënshkruar e vulosur me punonjësit e profileve të ndryshme për ndërtim	Dëshmia 6. Lista e stafit me kualifikime profesionale dhe pregaditje shkollore minimum 30 puntorë të profileve të ndryshme.
	Kërkesa 7. Raportin për veglat dhe pajisjet teknike që janë në dispozicion të operatorit ekonomik për realizimin	Dëshmia 7. Një deklaratë e nënshkruar dhe vulosur për veglat dhe pajisjet teknike në dispozicion për realizimin e projektit (origjinalin). Data e deklaratës nuk mund të jetë
12		
6.7. Deklarata e Tërbësimit dhe e Përgatitjes		
	e projektit. Vegla dhe pajisje teknike ne baze te specifikave te projektit.	më herët se data e publikimit të njoftimit të kontratës dhe i referohet aktivitetit në fjalë. Autoriteti kontraktues rezervon te drejtën që me rastin e zgjedhjes së fituesit nëse e sheh të nevojshme të kërkojë verifikimin e tyre në <u>vend</u> .
	Kërkesa 8.-kriteret per gazra medicinale 1. Punëtor të certifikuar për saldim të gypave të bakrit medicinal: min 2 punëtor 2. Operatori ekonomik ka per obligim te angazhoi nje trup te autorizuar per vlersimin e konformitetit , kalibrimit , testimit , certifikimin dhe kontrollet periodike te pajisjeve nen presion nga Ministria e Ekonomise. Trupi i autorizuar duhet te ket se paku nje puntore te certifikuar per testim te lidhjeve te përhershme te pajisjeve nen presion me metodën e testimit radiografik dhe ultrasonik sipas standardit DIN EN ISO 9712:2012.	Dëshmit 8 1. Te deshmohe me certifikata per saldimin e gypave gazra medicinale , Kontrata e punës valide ose parakontrat lidhur me punëdhënësin per kete projekt. 2. Te deshmi: marrveshja e bashkëpunimit , parakontrat me trupin e autorizuar ose deklarata me shkrim nga Operatori ekonomik qe do ta angazhoi nje trup te autorizuar per vlersimin e konformitetit , kalibrimit , testimit , certifikimin dhe kontrollet periodike te pajisjeve nen presion nga Ministria e Ekonomise. Trupi i autorizuar duhet te ket se paku nje puntore te certifikuar per testim te lidhjeve te përhershme te pajisjeve nen presion me metodën e testimit radiografik dhe ultrasonik sipas standardit DIN EN ISO 9712:2012.

		Kërkesa 9. Krite për paisje dhe material për ngrohje, klimatizim dhe ventili 1.Minimum dy saldues të certifikuar për saldime për gypat celikut të zi për sisteme të ngrohjes 2.Katalogu nga prodhuesi me përshkrimet teknike,në katalog të nënvizohet pasija të cilën e ofertoni	Dëshmia 9 1.<u>Te</u> deshmohet me certificate për saldime për gypat celikut, Kontrata e punës valide ose parakontrat lidhur me punëdhënësin për këtë projekt. 2.katalogu për pjesët kryesore që i ofron për fazën makinerike e jo për çdo material.
		Kërkesë 10. Katalogu për elemente të sanitarisë	Dëshmia 10. Te deshmohej katalogu për elemente të sanitarisë nga prodhuesi me përshkrime teknike për elemente spitalore
		Kërkesa 11. Plani dinamik (ditë pune) për egzekutimin e punëve brenda 36 muajve	Dëshmia 11. Plani dinamik i punëve (ditë pune) nga OE brenda 36 muajve.sipas fazave me grafikun

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

OE ankues është i përgjegjshëm.

OE i rekomanduar për kontratë është i përgjegjshëm.

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - H & B - Consulting SH.P.K.

Përgjigje ne pretendimet ankimore të OE ankues H&B Consulting:

OE ankues H&B Consulting pas përfundimit të rezultatit të vlerësimit është njoftuar nga AK-ja se OE ankues është i papërgjegjshëm, me arsyetimin se:

Keni bërë Gabim në llogaritjen e çmimit njësi Pozicioni G5.10 (Ky çmim njësi është dashtë të llogaritet me mbledhjen e pozicioneve nga G5.1 deri G5.9). Sipas nenit 47.23 të “RREGULLAT dhe UDHËZUESI OPERATIVI për PROKURIMIN PUBLIK” në asnjë rast nuk mund korrigjohet çmimi për njësi. Për më tepër shih nenin 41.10b të këtij udhëzuesi, si rrjedhojë ju jeni ofertë e papërgjegjshme. Me katalogun për elemente të sanitarisë ju nuk keni paraqitur katalogun për elementet spitalore siç është kërkuar në dosjen e tenderit që si rrjedhojë bazuar në kërkesen dhe evidencen ju jeni ofertë e pa përgjegjshme sepse katalogu i juaj nuk ju referohet asnjë elementi spitalor.

Eksperti teknik, bazuar në nenin 113, të LPP-se, sqaron se pretendimet ankimore të OE “H&B Consulting” shpk – Prishtine, kanë të bëjnë kryesisht me arsyetimin e eliminimit të përcaktuara në letrën standarde të datës 31.08.2023.

AK – QKUK, si arsyetim të eliminimit ka përcaktuar: *“Keni gabim në llogaritjen e çmimit për njësi Pozicioni G5.10, çmimi njësi është dashtë të llogaritet me mbledhjen e pozicioneve G5.1 deri G5.9 dhe me katalogun për elemente të sanitarisë ju nuk keni paraqitur katalogun për elemente spitalore siç është kërkuar në dosjen e tenderit, rrjedhimisht oferta juaj është e pa përgjegjshme...”*

Përgjigje ne pretendimin ankimore 1:

Eksperti Teknik, lidhur me arsyetimin e pare të eliminimit sqaron se pozicioni G5.10, i paramases dhe parallogarise se krijuar nga AK – QKUK, është përcaktuar si me poshtë:

“Fitingu për gypa bakrit, si mbajtëse, përforcuesit, kthesa, gasi për saldim etj. Është 40% nga pozicioni 5.1 deri 5.9”. Për këtë pozicion AK – QKUK, si njësi matëse e ka përcaktuar: % (përqindje) ndërsa sasinë 0.4.

Operatori Ekonomik ankues, tek çmimi për njësi ka përshkruar vlerën prej **24,390.00€**, përderisa vlera totale nga pozicioni 5.1 deri 5.9, i ofruar nga i njëjti OE del te jete: **83,110.00€**, ku AK nëpërmjet letrës standarde për sqarimin e tenderit llogaritje e gabuar OE ka pranuar korrigjimet aritmetike, te cilat nuk tejkalojnë vlerën me shume se 2% ashtu siç ceket në nenin 59, paragrafi 3 i ligjit për Prokurim Publik përcakton: *“Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë*

tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës.

Po ashtu duhet te theksohet se kemi te bëjmë me potencim te gabuar nga AK referuar rregullores 001/22 ,pika

Përkatësisht pika **b)** e nenit 40,par 11, përcakton se:

“Në asnjë rast çmimi për njësi nuk mund të korrigjohet. Në rast se tenderuesi pretendon se ka bërë një gabim në çmimin për njësi, tenderi i tij do të refuzohet dhe konsiderohet si i tërhequr”, prandaj ky pretendim ankimore është i pa bazuar, marre parasysh se ne fazën e njoftimit për kontrate kërkesat e përcaktuara ne dosje te tenderit nuk janë kontestuar nga operatori ekonomik ankues. Pra kemi te bëjmë me çmim për njësi dhe jo çmim total, çmim ky i ndaluar ligjërisht te korrigjohet.

Operatori Ekonomik ankues ka bërë një gabim gjatë mbledhjes së pozicioneve në mënyrë që ka bërë mbledhjen vetëm të pozicioneve nga 5.1 deri në 5.6, në vend që të përfshijë të gjitha pozicionet nga 5.1 deri në 5.9, ashtu siç ishte kërkuar për pozicionin 5.10. Kjo ka çuar në një vlerë të pasaktë në pozicionin 5.10.

Pas korrigjimit të gabimit aritmetik, ka ndryshim në çmimin për njësi. Tabela më poshtë tregon se si duhej paraqitur situata në paramasë:

	Sasia	Njësi	P05/€
G5.1	1485	7	10,395.00
G5.2	145	9	1,305.00
G5.3	261	15	3,915.00
G5.4	65	24	1,560.00
G5.5	135	29	3,915.00
G5.6	55	60	3,300.00
G5.7	53	600	31,800.00
G5.8	14	780	10,920.00
G5.9	8	2000	16,000.00
G5.10	0.4	83,110.00	33,244.00

Përgjigje ne pretendimin ankimore 2

Autoriteti Kontraktues – QKUK, në letër standarde ka potencuar se nuk është prezantuar katalog lidhur me elementet spitalore.

Eksperti Teknik sqaron se, tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional ne pozicionin 10 te dosjes

se tenderit AK – QKUK, ka kërkuar:

“Katalogu për elementet e sanitarise”,

Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar:

“Te dëshmohet katalogu për elementet te sanitarise nga prodhuesi me përshkrime teknike për elementet spitalore”.

kurse për piken e pare te eliminimit edhe për këtë pike, operatori ekonomik ankues “H&B Consulting Shpk – Prishtine, ne ankese potencon se kërkesa me dëshminë nuk janë te harmonizuara njëra me tjetrën dhe i është referuar vetëm kërkesës.

Eksperti Teknik, vlerëson se përkundër faktit se kërkesa dhe dëshmia janë te çarta dhe te kuptueshme, si te tilla nuk janë kontestuar paraprakisht, është kërkuar te dëshmohet me katalog për elementet spitalore, rrjedhimisht operatori ekonomik ankues për këto elemente ne oferte nuk ka prezantuar ndonjë te dhëne nga ndonjë prodhues i caktuar për elementet spitalore, prandaj edhe ky pretendim ankimore është i pa bazuar.

Operatori Ekonomik ne ankese potencon se Autoriteti Kontraktues – QKUK, për këtë aktivitet te prokurimit përgjatë vlerësimit te ofertave ka qen dashur te kërkoj sqarime shtese për qeshje te katalogut.

Autoriteti Kontraktues – QKUK, për këtë aktivitet te prokurimit dhe për qeshje te caktuara, ka kërkuar sqarime shtese ndaj operatoreve ekonomik siç parashihet me nenin 59 dhe 72, te LPP-se dhe nenit 10 te RRPP-se, megjithatë marre parasysh piken e pare te eliminimit, plotësimi i katalogut dhe elementeve te sanitarise nuk do ta ndryshonte rezultatin e vlerësimit te ofertave.

Përgjigje në pretendimin ankimore 3

Eksperti Teknik, sqaron se, tek kërkesat e dosjes se tenderit, gjegjësisht në ANEKS1-SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETZRUESHME në pozicionet H-III nga 3.1 deri më 3.11, sa i përket pajisjeve sanitare ka kërkuar pajisje sipas specifikimit të jenë për nevoja të veçanta dhe pa ndonjë specifikim të detajuar teknik, bazuar në dokumentacionin e prezantuar në dosjen e OE të rekomanduar, shihet se OE ka prezantuar të katalog/dokumentin(11.1 KATALOGU PER OBJEKTE SPITALORE SANITARI.pdf) për pajisjet për të cilat janë prezantuar edhe të dhëna teknike të tyre(shiko nga faqe 27 e tutje të dokumentit të lartcekur), prandaj pretendimi ankimor i OE ankues se OE i rekomanduar nuk ka prezantuar katalog, nuk qëndron dhe se pretendimi ankimor në këtë çështje është i pabazuar.

Sa i përket kërkesave e dosjes se tenderit apo kërkesave tjera, eksperti shqyrtues – teknik, sqaron se dispozitat e nenit 108/A i LPP-se, përcaktojnë mundësinë e kontestimit te kërkesave kualifikuese, kundërthënien ne mes tyre apo edhe përcaktimin e kërkesave kufizuese – favorizues, konkretisht paragrafi 3.1, përcakton qe: “ne qofte se shkelja e supozuar ka te beje me njoftimin për kontrate ose dokumentet e tenderit brenda 5 ditëve para afatit te fundit për dorëzim te ofertave.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtuar nga OE “**H & B - Consulting SH.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Ndërtimi i objektit për klinikat Nefrologji dhe Hemato-Onkologji**” me numër të prokurimit: “**701-23-1939-5-1-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVES**

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues- Teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtuar nga OE “**H & B - Consulting SH.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Ndërtimi i objektit për klinikat Nefrologji dhe Hemato-Onkologji**” me numër të prokurimit: “**701-23-1939-5-1-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVES**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVES**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **H & B - Consulting SH.P.K.**

Florije Rexhepi



vigan syla

